



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 4130/3 Prot
Dt. 31.07.24

Nr. 452/3 prot.

Shkodër, më 29.07.2024



LËNDA: Mbi vendimin Nr.46 datë, 26.06.2024 të Këshillit Bashkiak Vau-Dejës.

KESHILLIT BASHKIAK VAU-DEJES

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 “Për Prefektin” i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 “Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut”, në mbështetje të nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 27/5, neni 54/e/1, neni 55/3, neni 64/c të Ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 për “Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175dt.9.07.2020 “Për miratimin e rregullores së Brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”si dhe aneksi 1 “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut”, Kreu II, neni 4, Kërkesës për plotësim nga Prefekti Nr.452/1.prot datë.5.07.2024, *shqyrtoi dokumentacionin* e depozituar nga Bashkia Vau-Dejës Nr.4130/2prot datë.16.07.2024,“*Plotësim dokumentacioni*”, **mbi VKB Vau-Dejës nr.46 datë.26.06.2024** “Dhënie në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurrimit publik, me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.2937ha, pjesë e pasurisë nr.22,ZK nr.1100, e llojit “Kullotë”, në fshatin Barbullush, NJAD Bushat, Bashkia Vau-Dejës, “Për mbarështimin e faunës së eger...”). Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon zhvillimin e konkurrimit publik sipas qëllimit ligjore. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





Nr. 4130/Prot
Dt. 08.07.24



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Shkodër, më 05.07.2024

Nr. 452/1
prot.

Lënda: Kërkesë për plotësim.

KESHILLI BASHKIAK VAU-DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016 dt.2.10.2016 "Për Prefektin" i ndryshuar, Urdhërit të Kryeministrit Nr.50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", Urdhërit të Ministrit të Brendshëm Nr.175dt.9.07.2020 "Për miratimin e rregullores së Brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut" si dhe aneksi I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollit nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, referuar nenit 9, pika 1/1.2 germa a dhe c, neni 27/5, neni 55/3, neni 54/e/1, neni 64/c të ligjit Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, dokumentacionit të këshillit bashkiak Vau-Dejës Nr.4123prot datë.2.07.2024 të datës 26.06.2024", shqyrtoi **VKB Vau-Dejës Nr.46, datë 26.06.2024** "Dhënie pëlqimi në parim për dhënie në përdorim me anë të konkurrimit publik me afat deri në 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.2937ha, pjesë e pasurisë nr.22, ZK nr.1100, e llojit "Kullotë", fshati Barbullush, NJAD Bushat, Bashkia Vau-Dejës "Për mbarështimin e faunës së eger...).

Pas trajtimit konstatohet si vijon:

- Në zbatim të Urdhërit të MB Nr.175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brëndshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", Kreu II, neni 4, çertifikatës (për vërtetim pronësie) nr. 444817, pasuria nr.22, ZK nr.1100, lloji *kullote*, i mungon bashkelidhur praktika e plotë e ASHK-se, kopje e njehsuar e kartelës me origjinalin (jane fotokopje pa vulë),
- Bashkelidhur çertifikatës (për vërtetim pronësie) është nje plan rievimi per punime kadastrale që mban datën 8.05.2024 "Kalimi i arë ne pronesi" që trajton pasurinë nr.22, si are....., ndërsa në Çertifikatë është kullotë- kjo paraqet mospërputhje

Per sa trajtuar, Prefekti kërkon plotësim të dokumentacionit nga struktura përgjegjese në Bashki. Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI SHQIPËRISË
Majlinda ANGONI
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr 46 Datë 26.062024

Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 0.2937 ha, pjesë e pasurisë nr 22, Zk nr 1100, e llojit “Kullotë”, me afat deri 10 vjet, në fshatin Barbullush, “Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut”.

Bazuar në nenin 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 3, neni 27 pika 5, të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.02.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 246 dt 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr 68, datë 28.08.2008 të Këshillit të ministrave, për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme, publike të shtetit që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, VKM nr 559, dt 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”, çertifikaten e pronësisë nr 444817, datë 28.06.2011, si dhe pas shqyrtimit të Projekt Vendimit Nr 04, dt 10.06.2024, paraqitur nga Drejtoria Juridike Prokurimeve Integritetit dhe Aseteve, Sektori i Aseteve, ku propozohet dhënia e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim me anë të konkurimit të një pjese të pasurisë nr 22, Zk nr 1100, e llojit “Kullotë”, “Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut”, pas diskutimit dhe miratimit me shumicë të votave, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI :

1. Miratimin në parim të dhënies në përdorim me anë të konkurimit me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.2937 ha, pjesë e pasurisë nr 22, Zk nr 1100, e llojit Kullotë, fshati Barbullush, NJAD Bushat, Bashkia Vau Dejës.
2. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohet Drejtoria Juridike Prokurimeve Integritetit dhe Aseteve, si dhe administrata e Bashkisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE

3. Pas shprehjes së ligjshmërisë nga ana e prefektit të Qarkut Shkodër, do vazhdohet me procedurat standarde të konkurimit publik, me të gjithë elementët e saj përbërës, sipas Udhëzimit nr 1, datë 09.06.2016, të Ministrit të Mjedisit, “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit, e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit kullor publik”, deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes Publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të ligjit nr 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar).

Kryetar i Këshillit

Ervis Shintaj

Miratuar me 20 vota

Vota pro 20

Vota kundër —

Vota abstenim —

Zbardhur me datë 02 07 2024



Sekretar i Këshillit

Ardian Çelepija



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETERVE
Sektori i Aseteve

Projekt – Vendim

Nr 04 Dt 10.06, 2024

Dhënie pëlqimi në parim, për dhënie në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.2937 Ha, pjesë e pasurisë nr 22, Zk 1100, e llojit “Kullotë”, në fshatin Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës. “Për mbarëshkrimin e faunës së egër dhe gjahut”.

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ndryshuar, neni 8 pika 2, neni 9 pika 1/1, 2, neni 18, neni 54 shkronja “e/1” (ndryshuar), neni 55 pika 3, neni 27 pika 5, ligji nr 38/2019, ligji nr 8743, datë 22.01.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, ligji nr. 8744 datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njesitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, VKM nr. 246, datë 31.03.2011, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr 68, datë 28.01.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”, VKM nr 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore.”, çertifikatën e pronësisë nr 444817, datë 28.06.2011, Udhëzimin nr 1, datë 09.06.2016 të Ministrisë së Mjedisit “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës të:

VENDOSI :

1. Miratimin në parim për dhënien në përdorim me anë të konkurimit, me afat deri 10 vjet, të sipërfaqes prej 0.2937 ha, (sipas plan rilevimit bashkëlidhur), e llojit “Kullotë”, pjesë e pasurisë nr 22, Zk nr 1100, fshati Barbullush, Bashkia Vau Dejës. Fusha e përdorimit të pronës të jetë: “Për mbarëshkrimin e faunës së egër dhe gjahut”.
2. Efektet: Jep impakt pozitiv në komunitet duke hapur vende të reja pune, si dhe sigurohen të ardhura për Bashkinë, që kthehen më pas në investime publike.
3. Vlera dysheme e qirasë vjetore të jetë sipas pikës 4/4, shtojca nr 1, të VKM-së Nr 559, datë 29.07.2022, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.


4. Pas miratimit në Këshill Bashkiak dhe shprehjes së ligjshmërisë nga ana e prefektit të Qarkut Shkodër, do vazhdohet procedura me të gjithë elementët e saj përbërës, shpalljen në Buletinin e njoftimeve publike, dhe zhvillimin e konkurimit publik, deri në lidhjen e kontratës së qirasë me subjektin fitues.

HARTOI PROJEKT VENDIMIN
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETERVE

Konceptoi: Sp/Juriste Denada Dodaj

Miratoi: P/sek Aseteve Ndoc Baqli

Pranoi: Drejtori Marinela Deda



KRYETARI

Kristian SHKRELI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETARI

Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS
DREJTORIA JURIDIKE PROKURIMEVE INTEGRIMIT DHE ASETERVE
Sektori i Aseteve

RELACION

Dhënie në përdorim me anë të konkurimit të sipërfaqes prej 0.2937 ha, e llojit Kullotë, fshati Barbullush, pronë e Bashkisë Vau Dejës, *“Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut”*.

Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar këshilltarë,

Administrimi i asetëve publike në territorin e Bashkisë Vau Dejës, është një ndër funksionet e Bashkisë, i përcaktuar në nenin nr 27 të ligjit nr. 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, i ndryshuar, ku në piken 5 të këtij neni përcaktohet: Funksionet e Bashkive në fushën e bujqësisë, zhvillimit rural, pyjeve dhe kullotave publike, natyrës dhe biodiversitetit:

Bazuar në Ligjin nr 139/2015 *“Për vetëqeverisjen vendore”*, neni 9 pika 1.2 c , neni 54 pika e/l, neni 18, është kompetencë e Këshillit të Bashkisë , dhënia me qira e Pasurive në pronësi të Bashkisë.

Udhëzimi i Ministrit të Mjedisit nr. 1 datë 09.06.2016 *“Për rregullat , procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”* pika 7.

Objekt i këtij projekt vendimi, është sipërfaqja prej 0.2937 Ha, pjesë e pasurisë nr 22, Zk nr 1100, fshati Barbullush, e cila bën pjesë në inventarin e asetëve të Bashkisë, të transferuara me VKM nr 246, datë 31.03.2011, *“Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr 68, datë 28.01.2008, Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bushat të Qarkut të Shkodrës”*. Kjo pasuri është me certifikatë pronësie (bashkëlidhur projekt vendimit), është e llojit “Kullotë” me sipërfaqe të përgjithshme prej 13 580 m², nga e cila propozohet të jepet në përdorim një pjesë e saj, konkretisht sipërfaqja prej 2937 m², ose 0.2937 Ha, sipas plan rievimit bashkëlidhur.

Duhet të sqarojmë se për këto pasuri të llojit Kullotë, të përfshira në inventarin e Aseteve, nuk kemi patur kërkesa për përdorime të tjera, si kositje bari, për stane, apo për kullotje të bagëtive, etj nga subjekte të ndryshëm privatë. Ndodhur në këto kushte, bashkia me qëllimin e vënies në efikasitet të pronave publike në pronësi të saj, me impakt rritjen e të ardhurave, si dhe duke hapur vende të reja pune, i propozon këshillit here pas here për ti dhënë në përdorim këto prona, për përdorime të ndryshme, por gjithmonë duke patur prioritet ndër të tjera edhe ruajtjen e karakteristikave të pronës, ekuilibrin e natyrës dhe biodiversitetit, si dhe funksionet bazike të saj.

Sipërfaqja që propozohet të jepet në përdorim është 2937 m², ose 0.2937 ha.

Në funksion të sipërfaqes që merret në përdorim, sipas VKM-së nr. 559, datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore Pyjore", Shtojca 1, pika 4/4, si dhe bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit si më poshtë.

8. Për mbarështimin e faunës së egër dhe gjahut.				
Nr.	Përdorimi i territorit	Sipërfaqja e përdorur në ha	Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha në vit	
			1 vit	2- 5 vjet 6-10 vjet
1	Kullotë	24 000	23 000	20 000

Nga llogaritja e vlerave dysHEME sipas tabelës më sipër del: Sip 0.2937 ha x 20 000 lek/ha në vit = 5 874 lekë/vit.

Sa më sipër, propozojmë miratimin në parim të këtij projekt vendimi.

Hartuesit e relacionit

Ndoc Baqli



Denada Dodaj



Arjeta Garubi



KRYETARI
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV/KRYETARI
Aleksandra Gjoni





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURISË SË PALUAJTSHME

ÇERTIFIKATË
PËR VËRTETIMI PRONËSIE

444817

Zyra e Regjistrimit SHKODER Zona Kadastrale Nr. 1100
 Numri i Pasurisë 22 Volumi 1 Faqe 161
 Adresa e Pasurisë BARBULLUSA-SHKODER
 Lloji i Pasurisë KULLOTE
 Sipëriaqja Totale 13580 m² (TREM BE DH JETEMITE E RESEKONDE E FETE JAJETE) m²
 Nga kjo : Sa Truall - Nga kjo : Sa Ndërtesa -
 Nqs pallat : Kuota e pjesëmarrjes - %

KJO ÇERTIFIKATË LËSHOHET PËR TË VËRTETUAR QË


Zoti (Zotërinjtë)			Pjesa	Adresa
Emri	Atësia	Mbiemri		
<u>KOMUNA</u>	<u>BUSHAT</u>		<u>1</u>	<u>BUSHAT-SHKODER</u>

- është pronar i PASURISË ME NR. 22
 - janë bashkëpronarë sipas pjeseve më lart
 - është përfaqësues i familjes e cila ka në pronësi 759/1 J 762 P 762
 - kufizimet e pasurisë janë : V20, 26, 27, 25, 159

Kjo certifikatë plotësohet në përputhje me Ligjin e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Kjo certifikatë lëshohet sipas kërkesës së paraqitur nga i (të) interesuari (t) më datë 07.06.2011 Nr. 759/1 J 762 P 762

Data e lëshimit të certifikatës
28.06.2011



PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI: BASHKIA VAUDEJES .

DATE: 08.05.2024

QELLIMI: KALIM I ARES NE PRONESI

VENDNDODHJA

BASHKIA: VAUDEJES DV. ASHK: SHKODER ZONA KADASTRALE: 1100 NR. I PASURISE: 22 VOL. 1 FQ. 161 INDEKS HARTE: K-34-76- (34- C)


TE DHENAT E PASURISE

LOJI I PASURISE: Are SIP. PASURISE = 2937 m² SIP. TRUALLIT = M2 NUMRI KATEVE: NUMRI PEMEVE: -
SIP. NDERTESES = M2

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X, 463578.97 Y, 4644435.20

X, 463540.02 Y, 4644414.84



X, 463649.91 Y, 4644296.96

X, 463612.81 Y, 4644271.13

SHKALLA 1:2500

NR.	ORIENTIMI	Nr. PASURISE	TIPI I KUFITARIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME
1	VERI	25	SHTET	SHTET	-	Kufizimet e prones
2	JUG	762	SHTET	SHTET	-	Kufizimet e prones
3	LINDJE	22	SHTET	SHTET	-	Kufizimet e prones
4	PERENDIM	667	INDIVID	INDIVID	-	Kufizimet e prones



REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI: ALBERT MARKOAJ

LICENCA: NR. T.1230 DATE: 29.05.2017

NENSHKRIMI / VULA:

KONFIRMOI

PERGJEGJESI / DREJTORI: _____

NENSHKRIMI / VULA: _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE: T-Terren, O-Ortofoto
Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash.

PERCAKTIMI I KUFIRIT: P-Perfaqesues i Pronareve, HK- Harte Kadastrale, KP
Kode per percaktimin e kufirit: P-Perfaqesues i Pronareve; K-Kufitaret te Gjithe; KP-Kufitaret Pjeserisht;

PB-Perfaqesues Bashkie; HK-Harta Kadastrale.
SHENIME TE VECANTA: Plan Rilevimi realizohet me kerkese te banorit per kalimin ne pronesi te prones me nr. pasurie 22, sipas VKM 1174 date 24.12.2020.

PRONARI / BASHKEPRONARET:

EMRI: _____

NENSHKRIMI: _____